

VENDIM
Nr. 665, datë 2.9.2026

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE NË BAZË TË TË CILAVE BËHET
VLERËSIMI I KËRCËNIMIT TË MUNDSHËM DHE PËRCAKTIMI I DËMIT NË
MJEDIS¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim miraton kriteret për vlerësimin e kërcënimit të menjëhershëm për dëm në mjedis dhe për përcaktimin e dëmit në mjedis, me qëllim zbatimin e masave parandaluese dhe rehabilituese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

2. Për qëllime të këtij vendimi, termat e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin që u jepet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Dëm”** konsiderohet çdo ndryshim negativ i matshëm në një burim natyror ose çdo cenim i matshëm i shërbimeve të ofruara nga një burim natyror, i shkaktuar drejtpërdrejt ose tërthorazi;

b) **“Dëm mjedisor”** konsiderohet:

i. dëmtimi i llojeve të mbrojtura dhe i habitateve natyrore, që përfshin çdo dëm që ka ndikime të konsiderueshme negative në arritjen ose ruajtjen e statusit të favorshëm të ruajtjes së këtyre habitateve ose llojeve. Këto ndikime vlerësohen në raport me gjendjen e mëparshme, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Dëmtimi i llojeve të mbrojtura dhe i habitateve natyrore nuk përfshin ndikimet negative të identifikuara paraprakisht, të cilat rrjedhin nga një veprim i operatorit, i autorizuar shprehimisht nga autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit, habitateve dhe llojeve të mbrojtura;

ii. dëmtimi i ujërave, që përfshin çdo dëm me ndikim të konsiderueshëm negativ në statusin ekologjik, kimik ose sasior, apo në potencialin ekologjik të ujërave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për burimet ujore, si dhe në gjendjen mjedisore të ujërave detare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit detar. Dëmtimi i ujërave nuk përfshin ndikimet negative të lejuara, në përputhje me përjashtimet e parashikuara nga legjislacioni përkatës në fuqi;

iii. dëmtimi i tokës, që përfshin çdo ndotje të tokës, e cila krijon një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e njeriut, si pasojë e futjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë të substancave, preparateve, organizmave ose mikroorganizmave në, mbi ose nën tokë;

c) **“Gjendje e mëparshme”** konsiderohet gjendja e burimeve natyrore dhe e shërbimeve të tyre në kohën e shkaktimit të dëmit, e cila do të kishte ekzistuar nëse dëmi në mjedis nuk do të kishte ndodhur, e vlerësuar mbi bazën e informacionit më të mirë të disponueshëm;

ç) **“Kërcënim i menjëhershëm për dëm mjedisor”** konsiderohet mundësia e mjaftueshme që një dëm i tillë të ndodhë në të ardhmen e afërt;

¹ Ky vendim synon përafrimin e pjesshëm të direktivës 2004/35/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për përgjegjësinë mjedisore, në lidhje me parandalimin dhe riparimin e dëmit mjedisor” (OJ L 143, 30.4.2004, f. 56) (CELEX 32004L0035), të ndryshuar.

d) “**Masa parandaluese**” konsiderohen të gjitha masat e marra në përgjigje të një ngjarjeje, veprimi ose mosveprimi, që ka krijuar një kërcënim të menjëhershëm për dëm në mjedis, me qëllim parandalimin ose minimizimin e këtij dëmi;

dh) “**Shërbime të ofruara nga burimet natyrore**” konsiderohen funksionet që kryhen nga një burim natyror, në dobi të një burimi tjetër natyror ose të publikut;

e) “**Veprimtari profesionale**” konsiderohet çdo veprimtari e ushtruar në kuadër të një aktiviteti ekonomik ose biznesi, publik ose privat, fitimprurës ose jofitimprurës.

3. Ky vendim nuk zbatohet për dëmin në mjedis ose për kërcënimin e menjëhershëm për një dëm të tillë, kur dëmi ose kërcënimi i menjëhershëm, është:

a) pasojë e një konflikti të armatosur, armiqësie, lufte civile ose kryengritjeje;

b) rezultat i aktiviteteve, qëllimi kryesor i të cilave është mbrojtja kombëtare ose siguria ndërkombëtare apo i aktiviteteve, qëllimi i vetëm i të cilave është mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore;

c) pasojë e dëmeve që vijnë nga një incident, për të cilin përgjegjësia ose dëmshpërblimi bien brenda fushës së zbatimit të konventave ndërkombëtare, të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë;

ç) pasojë e rreziqeve nukleare, që rrjedhin nga veprimtari të mbuluara nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në fushën e energjisë bërthamore, ose nga një incident apo veprimtari për të cilin përgjegjësia ose kompensimi bien brenda fushës së zbatimit të ndonjë prej instrumenteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

4. Zbatimi i këtij vendimi nuk cenon të drejtën e operatorit për të kufizuar përgjegjësinë e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon kufizimin e përgjegjësisë për kërkesat detare dhe për veprimtaritë e lundrimit të brendshëm.

5. Në rastet e ndotjes me karakter difuz, ky vendim zbatohet vetëm kur është e mundur të përcaktohet një lidhje shkakësore midis dëmit në mjedis ose kërcënimit të menjëhershëm për një dëm të tillë dhe veprimtarive të operatorëve individualë.

II. KRITERET PËR VLERËSIMIN E KËRCËNIMIT TË MUNDSHËM DHE TË MENJËHERSHËM TË DËMIT MJEDISOR

1. Vlerësimi i ekzistencës së një kërcënimi të menjëhershëm për dëm mjedisor bazohet në këto kritere, për aq sa janë të zbatueshme, sipas rastit:

a) Natyra, sasia, përqendrimi dhe rrezikshmëria e substancave ndotëse ose e faktorëve të tjerë dëmtues;

b) Probabiliteti që dëmi të ndodhë dhe afati kohor, brenda të cilit ai mund të ndodhë;

c) Afërsia me burime ujore, habitate natyrore, lloje të mbrojtura, zona të mbrojtura, zona të banuara ose zona të tjera të ndjeshme mjedisore;

ç) Ekzistenca e rrugëve të mundshme të përhapjes së ndotjes ose të faktorëve dëmtues në ajër, ujë, tokë, habitate ose zinxhir ushqimor;

d) Gjendja teknike, niveli i sigurisë dhe funksionimi i instalimeve, pajisjeve, proceseve ose sistemeve të kontrollit;

dh) Shkalla e mundshme e dëmit, përhapja territoriale, kohëzgjatja dhe mundësia e rikuperimit natyror;

e) Rreziku i mundshëm për shëndetin e njeriut;

ë) Historiku i incidenteve, mosfunksionimeve, shkeljeve ose ngjarjeve të ngjashme të lidhura me veprimtarinë e operatorit.

2. Vlerësimi i kërcënimit të menjëhershëm për dëm në mjedis kryhet, rast pas rasti, mbi bazën e informacionit më të mirë të disponueshëm, të dhënave teknike, inspektimeve në terren, analizave laboratorike, të dhënave të monitorimit dhe çdo informacioni tjetër të nevojshëm. Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë procesit të vlerësimit përcakton, të paktën:

a) burimin e mundshëm të kërcënimit ose të dëmit;

b) veprimtarinë profesionale dhe operatorin ose operatorët e mundshëm të lidhur me këtë burim;

c) burimin natyror ose shërbimin e burimit natyror që mund të preket;

ç) rrugët e mundshme të përhapjes së ndotjes ose të faktorëve dëmtues;

d) mundësinë, afatin kohor dhe shkallën e ndodhjes së dëmit;

dh) nevojën për masa parandaluese ose për vijimin e procedurës për përcaktimin e dëmit në mjedis, sipas rastit.

3. Për qëllime të vlerësimit, merren në konsideratë:

a) përshkrimi i ngjarjes, incidentit, veprimit ose mosveprimit, që ka krijuar kërcënimin ose dëmin;

b) vendndodhja, hartat, koordinatat dhe përhapja e mundshme territoriale e ndikimit;

c) të dhënat për substancat, preparatet, organizmat, mikroorganizmat ose faktorët e tjerë dëmtues;

ç) lejet, autorizimet, raportet e vetëmonitorimit, raportet e inspektimit dhe të dhënat e shkarkimeve ose emetimeve;

d) rezultatet e analizave laboratorike, matjeve në terren dhe të monitorimit mjedisor;

dh) të dhënat për gjendjen e mëparshme të burimeve natyrore dhe të shërbimeve të tyre;

e) informacioni për llojet e mbrojtura, habitatet natyrore, ujërat, tokën dhe zonat e ndjeshme që mund të preken;

ë) masat e marra ose të propozuara nga operatori për parandalimin, kufizimin ose kontrollin e dëmit.

4. Për përcaktimin e lidhjes shkakësore, ndërmjet dëmit në mjedis ose kërcënimit të menjëhershëm për një dëm të tillë dhe veprimtarisë së operatorit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim AKM) bazohet, ndër të tjera, në:

a) lidhjen kohore ndërmjet veprimtarisë, incidentit, emetimit ose shkarkimit dhe shfaqjes së dëmit apo kërcënimit;

b) lidhjen hapësinore ndërmjet burimit të mundshëm të ndotjes dhe burimit natyror të prekur;

c) përputhjen ndërmjet natyrës së substancave ose faktorëve dëmtues dhe llojit të dëmit të konstatuar;

ç) rrugët e mundshme të transportit ose përhapjes së ndotjes në ajër, ujë, tokë, habitate ose në zinxhirin ushqimor;

d) rezultatet e monitorimit, analizave laboratorike, modelimeve teknike ose vlerësimeve të ekspertëve;

dh) ekzistencën ose mungesën e shkaqeve alternative të arsyeshme për dëmin e konstatuar.

5. Kërkesa drejtuar AKM-së shoqërohet me informacionin dhe të dhënat përkatëse, që mbështesin vëzhgimet e paraqitura.

6. AKM-ja, në rastin e pranimi ose refuzimit të kërkesës për veprim, njofton brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, palët përkatëse dhe jep arsyet e vendimit. Vendimi i AKM-së duhet të jetë i argumentuar dhe të mbështetet në kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

7. Pas përcaktimit të dëmit mjedisor dhe përpara miratimit të masave rehabilituese, AKM-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve punë fton palët e përmendura, si dhe personat, në pronën e të cilëve do të zbatohen masat të paraqesin vëzhgimet e tyre. Këto vëzhgime merren në konsideratë gjatë vendimmarrjes.

8. Masat e marra nga AKM-ja nuk përjashtojnë dhe nuk kufizojnë përgjegjësinë e operatorit për dëmin mjedisor.

9. Çdo vendim i AKM-së për marrjen e masave parandaluese ose rehabilituese duhet të jetë i arsyetuar dhe të përcaktojë bazën faktike e ligjore mbi të cilën mbështetet. AKM-ja informon operatorin për të drejtën e ankimit, mjetet juridike dhe afatet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Çdo vlerësim ose vendim i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për kërcënimin e menjëhershëm ose dëmin në mjedis përmban, së paku:

- a) përshkrimin e ngjarjes, veprimtarisë ose rrethanave që kanë krijuar kërcënimin ose dëmin;
- b) identifikimin e operatorit ose operatorëve të mundshëm, kur kjo është e mundur;
- c) burimin natyror ose shërbimin e burimit natyror të prekur ose që rrezikon të preket;
- ç) të dhënat dhe provat mbi të cilat mbështetet vlerësimi;
- d) analizën e lidhjes shkakësore;
- dh) vlerësimin e rëndësisë së dëmit ose të mundësisë së ndodhjes së tij;
- e) bazën ligjore dhe faktike të vendimit;
- ë) masat parandaluese që kërkohen dhe, kur është e nevojshme, referimin te masat rehabilituese të propozuara ose të miratuara;
- f) afatet për zbatimin e masave, kur ato përcaktohen;
- g) të drejtën e ankimit dhe afatet përkatëse.

11. Vlerësimi ose vendimi dokumentohet, sipas rastit, duke u bazuar në formatin e përcaktuar në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pa cenuar marrjen në konsideratë të çdo informacioni tjetër të nevojshëm.

12. Kur dëmi në mjedis prek ose mund të prekë territorin e një shteti tjetër, AKM-ja bashkëpunon me autoritetet përkatëse të atij shteti dhe shkëmben informacionin e nevojshëm. Në rast se dëmi ka origjinën në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe mund të prekë një shtet tjetër, AKM-ja njofton në kohë autoritetet përkatëse të shtetit që mund të preket mbi natyrën e dëmit, burimin e mundshëm dhe masat e ndërmarra ose të propozuara.

III. KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E DËMIT MJEDISOR

1. Përcaktimi i dëmit mjedisor kryhet në raport me gjendjen e mëparshme të burimeve natyrore dhe të shërbimeve të tyre, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Rëndësia e dëmit vlerësohet, duke marrë parasysh:

- a) shkallën dhe përhapjen e ndikimeve negative;
- b) kohëzgjatjen e tyre;
- c) kapacitetin e burimeve natyrore për rikuperim natyror;
- ç) ndikimin në shëndetin e njeriut, kur është i provuar.

3. Për dëmtimin e llojeve të mbrojtura dhe të habitateve natyrore, vlerësimi i dëmit kryhet duke marrë parasysh kriteret e shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në veçanti ndikimin në statusin e favorshëm të ruajtjes, rolin ekologjik të zonës së dëmtuar, rrallësinë e llojit ose habitatit, kapacitetin për rigjenerim natyror dhe mundësinë e rikuperimit brenda një periudhe të shkurtër kohore.

4. Për dëmtimin e ujërave, vlerësimi kryhet duke marrë parasysh ndikimin e dëmit në statusin ekologjik, kimik ose sasior, potencialin ekologjik të ujërave, si dhe në gjendjen mjedisore të ujërave detare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për burimet ujore dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

5. Për dëmtimin e tokës, vlerësimi kryhet duke marrë në konsideratë nëse ndotja krijon rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e njeriut, si pasojë e futjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë të substancave, preparateve, organizmave ose mikroorganizmave në, mbi ose nën tokë. Në këtë vlerësim merren në konsideratë natyra dhe përqendrimi i ndotësve, përdorimi aktual ose i pritshëm i tokës, rrugët e ekspozimit dhe grupet e popullsisë që mund të preken.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Zbatimi i këtij vendimi bëhet pa cenuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, si dhe aktet e tjera nënligjore, të miratuara në zbatim të tij, për përgjegjësinë mjedisore, masat parandaluese dhe rehabilituese, përcaktimin e kostove dhe sigurimin e fondeve për kompensimin e dëmit në mjedis.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca 1

KRITERET PËR VLERËSIMIN E RËNDËSISË SË DËMIT NDAJ LLOJEVE TË MBROJTURA DHE HABITATEVE NATYRORE NË RAPORT ME GJENDJEN E MËPARSHME

Rëndësia e çdo dëmi, që ka ndikime të pafavorshme në realizimin ose ruajtjen e statusit të favorshëm të ruajtjes së habitateve ose të llojeve, duhet të vlerësohet duke iu referuar statusit të ruajtjes në kohën e shkaktimit të dëmit, shërbimeve të ofruara nga përfitimet që ato prodhojnë dhe kapacitetit të tyre për rigjenerim natyror.

1. Ndryshimet e rëndësishme të pafavorshme të gjendjes së mëparshme përcaktohen nëpërmjet të dhënave të matshme, si më poshtë vijon:

a) Numri i individëve, dendësia e tyre ose sipërfaqja e mbuluar;

b) Roli i individëve të veçantë ose i zonës së dëmtuar, në lidhje me ruajtjen e llojeve ose të habitatit, rrallësia e llojeve ose e habitatit (e vlerësuar në nivel lokal, rajonal dhe më të lartë, përfshirë edhe në nivel të Bashkimit);

c) Kapaciteti i llojeve për shumim (sipas dinamikave specifike për atë lloj ose për atë popullatë), qëndrueshmëria e saj ose kapaciteti i habitatit për rigjenerim natyror (sipas dinamikave specifike për llojet karakteristike të tij ose për popullatat e tyre);

ç) Kapaciteti i llojeve ose i habitatit që, pas ndodhjes së dëmit, të rikuperohet brenda një kohe të shkurtër, pa asnjë ndërhyrje tjetër, përveç masave të shtuara të mbrojtjes, në një gjendje që, vetëm në sajë të dinamikave të llojeve ose të habitatit, çon në një gjendje të konsideruar të barasvlershme ose më të mirë se gjendja mëparshme.

2. Dëmi me efekt të provuar të shëndeti i njeriut duhet të klasifikohet si dëm i rëndësishëm.

3. Në kuptim të këtij vendimi, veprimet ose situatat e mëposhtme nuk konsiderohen si dëm i rëndësishëm:

a) variacione negative që janë më të vogla se luhatjet natyrore të konsideruara normale për llojin ose habitatin përkatës;

b) variacione negative për shkak të shkaqeve natyrore ose që rrjedhin nga ndërhyrje që lidhen me menaxhimin normal të zonave, siç përcaktohet në regjistrat e habitateve ose në dokumentet e objektivave, ose siç është kryer më parë nga operatorët;

c) dëmtime të llojeve ose habitateve për të cilat vërtetohet se do të rikuperohen, brenda një kohe të shkurtër dhe pa ndërhyrje, ose në gjendjen e mëparshme, ose në një gjendje që, vetëm në sajë të dinamikave të llojeve ose të habitatit, çon në një gjendje të konsideruar të barasvlershme ose më të mirë se gjendja e mëparshme.

Shtojca 2

FORMATI PËR VLERËSIMIN E KËRCËNIMIT TË MENJËHERSHËM DHE PËRCAKTIMIN E DËMIT NË MJEDIS

Elementi i vlerësimit	Përshkrimi/të dhënat
Vendndodhja e ngjarjes	
Data dhe burimi i informacionit	
Operatorët e mundshëm	
Veprimtaria profesionale përkatëse	
Burimi natyror i prekur ose që rrezikon të preket	

Shërbimi i burimit natyror i cenuar ose që rrezikon të cenohet	
Përshkrimi i kërcënimit ose dëmit	
Gjendja e mëparshme e burimeve natyrore dhe e shërbimeve të tyre	
Të dhënat teknike/laboratorike	
Lidhja shkakësore	
Vlerësimi i rëndësisë së dëmit ose i mundësisë së ndodhjes së tij	
Baza ligjore e vlerësimit ose vendimit	
Masat parandaluese që kërkohen dhe, kur është e nevojshme, referimin te masat rehabilituese të propozuara ose të miratuara, sipas parashikimeve në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar	
Afatet për zbatimin e masave, kur përcaktohen	
Palët e konsultuara	
Përfundimi dhe arsyetimi	